



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Anketa e Kreditimit Bankar

## Numër 12

S H T A T O R 2 0 2 2

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin**

Numër 12

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike  
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| <b>Anketa e Kreditimit Bankar</b> .....   | 4  |
| Hyrje .....   | 4  |
| Përmbledhja e rezultateve .....   | 4  |
| Kutia 1. Metodologjia .....   | 7  |
| Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi..... | 8  |
| Kreditë ndaj ndërmarrjeve .....   | 8  |
| Standardet kreditore .....  | 8  |
| Kushtet dhe rregullat.....  | 9  |
| Kërkesa për kredi.....  | 10 |
| Kreditë ndaj ekonomive familjare .....  | 11 |
| Standardet kreditore .....  | 11 |
| Kushtet dhe rregullat.....  | 12 |
| Kërkesa për kredi.....  | 13 |
| Financimi .....   | 14 |
| Rezultatet e pyetjeve të fokusuara .....  | 15 |
| <b>Pritjet për Inflacionin</b> .....  | 17 |
| Metodologjia .....  | 17 |
| Përmbledhja e rezultateve .....   | 17 |

## Anketa e Kreditimit Bankar

### Hyrje<sup>1</sup>

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2022, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e tretë të vitit 2022.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me pesë pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste (evidente qysh prej gjysmës së dytë të vitit 2021) në dinamikat e kreditimit, si dhe ndikimin potencial në performancën e ripagimit të kredimarrësve. Gjithashtu, bankat elaboruan edhe mbi ndikimin indirekt të inflacionit në pozitën e likuiditetit dhe rritjen eventuale të kostove të financimit të sektorit bankar. Për më tepër, në pyetjet shtesë bëhet zbërthimi i ofertës dhe kërkesës kreditore sipas sektorëve ekonomik.

### Përmbledhja e rezultateve<sup>2</sup>

Pas përmirësimit të situatës me pandeminë në vitin paraprak, ekonomia shënoi një rimëkëmbje të fuqishme, mbështetur edhe nga rritja e kreditimit nga sektori bankar si dhe rritja e konsiderueshme e financimit. Rritja e lartë e kërkesës së përgjithshme në nivel global përgjatë vitit 2021 dhe fillimi i luftës Rusi-Ukrainë në tremujorin e parë 2022 rezultoi në pasiguri të shtuara dhe amplifikim të rritjes së çmimeve globalisht. Këto dinamika dhe pasojat që pritet të prodhojnë masat monetare, financiare dhe fiskale, janë reflektuar në ecurinë e pritjeve të bankave për ofertën dhe kërkesën kreditore për pjesën e mbetur të vitit 2022.

Rritja vjetore e stokut të gjithsej kredive vazhdoi me ritëm të përshpejtuar në gjysmën e parë të vitit 2022. Ndërkohë, kreditë e reja u karakterizuan me rënie vjetore dhe tremujore. Dinamikat e evidentuara në kreditim u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, e cila ishte shumëfish më e lartë se sa lehtësimi i ofertës kreditore. Pritjet për TM3 2022 sugjerojnë se kërkesa për kredi dhe oferta kreditore mbesin kryesisht të pandryshuara, gjë që sygjeron për rritje më të moderuar të kreditimit në pjesën e mbetur të vitit 2022.

Sipas bankave, dinamika e kreditimit të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua në masë më të madhe nga kërkesa e rritur kreditore, përderisa oferta kreditore nuk kishte ndryshime të rëndësishme. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan standarde kreditore të pandryshuara të aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e dytë të vitit 2022. Përgjigjet e bankave rezultuan me indeks negativ marginal për ndryshimet në standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha, përderisa për NVM-të nuk kishte ndryshim të rëndësishëm (tabela 1). Ndryshimet në standardet kreditore u ndikuan negativisht nga perspektiva e tregjeve ndërkombëtare, referuar ndikimit nga rritja e çmimeve globalisht, përderisa faktorët që ndikuan

<sup>1</sup> Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

<sup>2</sup> Pyetësori dhe seria kohore e rezultateve të AKB-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

pozitivisht duke i ofruar siguri sektorit bankar ishin qasja e favorshme në financim nga bankat amë, perspektiva e mirë e bankave amë, rritja e presioneve të konkurrencës, cilësia e mirë e portfolios kreditorë, si dhe mbështetja nga FKGK. Njëkohësisht, bankat rritën nivelin e aprovimit të kredive për ndërmarrjet, kryesisht për NVM-të. Për tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat përgjithësisht nuk presin të kenë ndryshime të rëndësishme në standardet kreditorë (grafik 1). Perspektiva në tregjet ndërkombëtare ishte faktori që ndikoi negativisht në standardet kreditorë, përderisa kontribut pozitiv dha mbështetja nga FKGK.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan marginalisht. Kushte dhe rregulla të lehtësuara u aplikuan për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, veçanërisht për NVM-të, përmes uljes së normës së interesit. Përderisa, edhe pse në nivel të ulët, shtrëngim u aplikua për ngarkesat tjera përveç interesit për të dy kategoritë, njëkohësisht për ndërmarrjet e mëdha u ndikua negativisht edhe maturiteti dhe shumica e aprovuar e kredive të reja. Faktorët që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave ishin rritja e presioneve të konkurrencës brenda sektorit bankar, qasja e favorshme në financim e bankës amë dhe mbështetja nga FKGK. Njëkohësisht, perspektiva në tregjet globale dhe pozita e likuiditetit të sektorit kontribuan negativisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara. Në tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat pritet të aplikojnë kushte dhe rregulla të shtrënguara mirëpo në nivel të ulët për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Kushtet dhe rregullat e shtrënguara pritet të aplikohen në normat e interesit dhe në nivel më të ulët në shumën e aprovuar të kredive. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e ndërmarrjeve pritet të nxiten nga pasiguritë në pozitën e likuiditetit të bankave. Megjithatë, si faktor me kontribut pozitiv ishte qasja e favorshme në financim nga bankat amë, si dhe mbështetja nga FKGK.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, kishte rritje të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet edhe pse në nivel më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet rezultoi të jetë nënvlerësuar në pritjet e bankave për TM2 2022, të shprehura në anketën e kaluar (TM1 2022). Kërkesa për kredi ishte e përafërt për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Kjo rritje e kërkesës, sipas deklaratave të bankave, u nxiti kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, si dhe për financimin e investimeve fikse në një nivel më të ulët. Pritjet për pasiguri të shtuara si pasojë e rritjes së vazhdueshme të nivelit të çmimeve në vend dhe jashtë tij i kanë ndikuar edhe pritjet e bankave të cilat deklaruan se presin rritje marginale të kërkesës për kredi, kryesisht nga NVM-të (tabela 1).






Stoku i kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje të konsiderueshme vjetore në qershor 2022, mirëpo kreditë e reja për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të dytë 2022 kishin rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe në krahasim me tremujorin paraprak. Ngjashëm me kreditimin e ndërmarrjeve, kërkesa kreditorë ishte nxitësi kryesor i dinamikave të aktivitetit kreditorë për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, përderisa oferta kreditorë kishte rol më të dobët në këtë aspekt. Standardet kreditorë në tremujorin aktual, në përgjithësi, rezultojnë të jenë të njëjta me pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar. Standardet kreditorë u lehtësuan në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese, përderisa për kreditë për blerjen e shtëpive ato mbetën po thuajse të pandryshuara. Këto lehtësime u ndikuan kryesisht nga presioni i rritur i konkurrencës në mes të bankave, qasja e favorshme në financim e bankave amë, si dhe cilësia e mirë e portfolios kreditorë. Në tremujorin e tretë 2022, bankat presin standarde kreditorë të shtrënguara në një nivel të ulët për kreditë për ekonomitë familjare. Standardet kreditorë pritet të shtrëngohen kryesisht për kreditë për blerjen e shtëpive, përderisa pritet lehtësim marginal për kreditë konsumuese (tabela 1). Faktori kyç me kontribut negativ në standardet kreditorë të aplikuara nga bankat për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të ardhshëm pritet të jetë perspektiva jo e favorshme në tregun e patundshmërive, përderisa rritja e presioneve të konkurrencës dhe qasja e favorshme në financim e bankave amë pritet të kenë kontribut pozitiv.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u lehtësuan. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë lehtësime për kreditë konsumuese, ndërsa shtrëngim për disa prej kushteve për kreditë për blerjen e shtëpive. Saktësisht, për kreditë konsumuese, bankat aplikuan kërkesë më të ulët për kolateral, normë më të ulët të interesit dhe rritën shumën e kredive të aprovuara. Ndërsa për kreditë për blerjen e shtëpive bankat aplikuan shtrëngime kryesisht për ngarkesat tjera përveç interesit dhe për maturitetin e kredive, përderisa i lehtësuan kërkesat për kolateral. Faktorët kyç që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare ishin cilësia e mirë e portfolios kreditorë, presioni i rritur i konkurrencës, si dhe qasja e favorshme në financim e bankave amë. Përderisa, perspektiva jo e favorshme e tregjeve globale kontribuoi negativisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat gjatë TM2 2022. Për tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat në përgjithësi presin shtrëngim në kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare, ngjashëm për të dy llojet e kredive. Shtrëngim pritet të ketë në normën e interesit dhe ngarkesat tjera përveç interesit, përderisa pritet lehtësim në nivel të ulët për kërkesat për kolateral dhe për maturitetin e kredive. Perspektiva e tregut të patundshmërive në vend, besueshmëria e klientëve, si dhe perspektiva jo e favorshme tregjet globale pritet të jenë faktorët nxitës të shtrëngimeve të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM3 2022. Përderisa, për lehtësimet, faktorë nxitës pritet të jenë qasja e favorshme në financim e bankave amë, si dhe perspektiva e mirë e tyre.

Në linjë me dinamikat në kreditimin e ekonomive familjare gjatë tremujorit të dytë 2022, kërkesa për kredi shënoi rritje mirëpo e përgjysmuar në krahasim me tremujorin paraprak. Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë konsumuese kundrejt atyre për kreditë për blerjen e shtëpive. Sipas bankave, kjo rritje u ndikua pozitivisht nga dy prej faktorëve të listuar në anketë, saktësisht nga nevoja për financim të konsumit dhe në një nivel më të ulët nga përmirësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive. Në tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, vetëm nga kreditë konsumuese. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që nevoja për financimin e shpenzimeve për konsum të ndikojnë deri në një masë kërkesën për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm.

**Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditorë**

|                              | Oferta<br>(Standardet kreditorë) |                    | Kërkesa  |                    |
|------------------------------|----------------------------------|--------------------|----------|--------------------|
|                              | TM2 2022                         | TM3 2022 (pritjet) | TM2 2022 | TM3 2022 (pritjet) |
| <b>Ndërmarrjet</b>           | →                                | →                  | ↗        | ↗                  |
| NVM                          | →                                | →                  | ↗        | ↗                  |
| Ndërmarrjet e mëdha          | ↘                                | →                  | ↗        | →                  |
| <b>Ekonomitë familjare</b>   | ↗                                | →                  | ↑        | ↗                  |
| Kredi për blerjen e shtëpive | →                                | ↘                  | ↗        | →                  |
| Kredi konsumuese             | ↗                                | ↗                  | ↑        | ↑                  |

 Lehtësim i standardeve kreditorë/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)  
 Lehtësim i standardeve kreditorë/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)  
 Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)  
 Shtrëngim i standardeve kreditorë/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)  
 Shtrëngim i standardeve kreditorë/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Rritja e aktivitetit ekonomik si pasojë e zhvillimeve pozitive globale dhe niveli i lartë i të hyrave nga jashtë vendit, si dhe monitorimi prudent i performancës financiare të klientëve ndihmuan në

përmirësimin apo mirëmbajtjen e performancës së ri-pagimit të kredive. Rrjedhimisht, bankat deklaruan përmirësim të portfolios kreditorë, pasi që indeksi i përgjithshëm i përgjigjeve edhe këtë tremujor qëndroi negativ, edhe pse në nivel më të ulët në krahasim me tremujorin e kaluar, e që nënkupton rënie të raportit në mes kredive jo-performuese dhe gjithsej kredive. Megjithatë, ky përmirësim vlen kryesisht për ndërmarrjet, ngase raporti i KJP-ve për ekonomitë familjare u karakterizua me indeks marginal pozitiv. Përderisa, për tremujorin e ardhshëm indeksi i gjeneruar pritet të ndërroj kahje dhe të kaloj në pozitiv, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditorë. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe nga rënia e fuqisë blerëse të klientëve.

Për dallim nga qasja e pandryshueshme në financim në tremujorin e kaluar (TM1 2022), në këtë tremujor gjithsej financimi shënoi rritje deri në një masë, bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e shtatë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, dhe një banke me rëndësi sistemike e cila deklaroi rënie deri në një masë të qasjes në financim. Financimi nga pothuajse të gjitha burimet e financimit u rrit. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, përderisa financimi nga ndërmarrjet kishte një rritje marginale. Ndryshim i veçantë dhe që duhet të theksohet është rritja e financimit nga bankat amë, kategori e cila rezultoi me indeksin pozitiv më të lartë qysh prej fillimit të realizimit të kësaj ankete. Financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare gjithashtu shënoi rritje edhe pse në një nivel të ulët. Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi kryesor për financim gjatë këtij tremujori. Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim në një nivel më të lartë se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ndërmarrjeve dhe me maturitet afatshkurtër pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar. Zhvillim i bazuar në pritjet për qarkullim më të lartë të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori. Përderisa financimi nga depozitat e ekonomive familjare dhe nga bankat amë pritet të ketë rritje gjithashtu, mirëpo në nivel më të ulët.

## Kutia 1. Metodologjia

### Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditorë përcaktohen nga standardet kreditorë të aplikuar gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuar për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga njëmbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë<sup>3</sup>. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun

<sup>3</sup> Banka e cila nuk është përfshirë në anketë është Komercialna Banka e cila ka aktivitet kreditor të limituar.



e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

### Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


## Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

### Kreditë ndaj ndërmarrjeve

#### Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022, rezultati për standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuar për ndërmarrjet në përgjithësi tregon për standarde kreditore të pandryshuara. Në anketën e kaluar (TM1 2022), bankat kishin deklaruar se presin standarde kreditore të pandryshuara, me indeks në nivel të përafërt me rezultatet aktuale (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuar për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks negativ marginal prej 0.07 për ndryshimet në standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha, përderisa për NVM-të nuk kishte ndryshim. Saktësisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e dy bankave pjesëmarrëse, njëra nga to me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan shtrëngim deri në një masë të standardeve kreditore për ndërmarrjet e mëdha, përderisa bankat e njëjta deklaruan shtrëngim deri në një masë edhe të standardeve kreditore për NVM-të kundrejt tre bankave me peshë më të vogël që deklaruan lehtësim për të njëjtat.

Faktori kryesor që ndikoi negativisht standardet kreditore ishte perspektiva e tregjeve ndërkombëtare me indeks negativ prej 0.16, duke iu referuar ndikimit të rritjes së çmimeve në nivel global. Përderisa, faktorët që ndikuan pozitivisht duke i ofruar siguri sektorit bankar ishin qasja e favorshme në financim e bankave amë (indeks pozitiv prej 0.21), perspektiva e mirë e bankave amë (indeks pozitiv prej 0.17), rritja e presioneve të konkurrencës (indeks pozitiv prej 0.16), cilësia e mirë e portfolios kreditore, si dhe mbështetja e NVM-ve nga FKGK me indeks pozitiv prej 0.15. Norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet u rrit kryesisht për NVM-të gjatë këtij tremujori në nivel më të lartë në krahasim me tremujorin paraprak. Saktësisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e gjashtë bankave pjesëmarrëse (prej tyre tre banka me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan rritje të normës së aprovimit të kredive për NVM-të, përderisa katër nga bankat deklaruan të njëjtën për ndërmarrjet e mëdha (prej tyre një bankë me rëndësi sistemike). Çfarë ndikoi në indeks të ulët pozitiv si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha ishte ulja e normës së aprovimit e deklaruar nga një prej bankave me peshë të madhe dhe rëndësi sistemike në sektor.


Bankat nuk pritet të kenë ndryshime të rëndësishme në standardet kreditore në përgjithësi gjatë TM3 2022. Konkretisht, indeksimi i përgjigjeve nuk reflektoi ndryshime të standardeve kreditore si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Perspektiva në tregjet ndërkombëtare ishte faktori që ndikoi negativisht në standardet kreditore, përderisa kontribut pozitiv dha mbështetja nga FKGK. Njëkohësisht, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet në përgjithësi nuk pritet të ketë ndryshim të rëndësishëm gjatë tremujorit të ardhshëm. Përderisa, nëse veçojmë kategoritë e ndërmarrjeve pritet të ketë rënie të normës së aprovimit të kredive për ndërmarrjet e mëdha me një indeks negativ marginal prej 0.08.

### Kushtet dhe rregullat

Në TM2 2022, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u lehtësuan marginalisht (grafiku 2). Sektori bankar aplikoi lehtësim më të lartë të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha. Konkretisht, për të dy kategoritë e ndërmarrjeve lehtësim deri në një masë kishte në normën e interesit të aplikuar (indeks pozitiv prej 0.15 për NVM-të dhe 0.12 për ndërmarrjet e mëdha) dhe në kërkesën për kolateral për NVM-të me indeks pozitiv marginal prej 0.06. Përderisa, shtrëngim edhe pse në nivel të ulët u aplikua për ngarkesat tjera përveç interesit për të dy kategoritë, njëkohësisht për ndërmarrjet e mëdha u shtrëngua në nivel të ulët edhe maturiteti e shuma e aprovuar e kredive të reja.

Faktori me kontributin kryesor në lehtësimin e kushteve dhe rregullave këtë tremujor ishte rritja e presioneve të konkurrencës brenda sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.26. Gjithashtu, pozitivisht kontribuan edhe qasja e favorshme në financim e bankës amë dhe mbështetja nga FKGK me indeks pozitiv prej 0.15 dhe 0.12, respektivisht. Ndërsa, perspektiva në tregjet globale dhe pozita e likuiditetit të sektorit kontribuan negativisht në kushtet dhe rregullat, konkretisht e ndikuar nga përgjigjet e dy bankave, ku njëra prej tyre është bankë sistemike me peshë të lartë në kreditimit.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Bankat gjatë TM3 2022 pritet të aplikojnë kushte dhe rregulla të shtrënguara mirëpo në nivel të ulët. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që presin shtrëngim të përafërt si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Tre banka, prej tyre dy me rëndësi sistemike e peshë të lartë në kreditim, presin rritje të normave të interesit për kredi deri në një masë, përderisa një bankë po ashtu me rëndësi sistemike deklaroi se pret ulje të normave të interesit, gjë që gjeneroi një indeks të ulët negativ prej 0.15 për NVM-të dhe 0.14 për ndërmarrjet e mëdha. Përderisa, kërkesa më të ulëta për kolateral pritet të ketë vetëm për NVM-të edhe pse me indeks pozitiv marginal prej 0.07. Shuma e aprovuar për kreditë e reja gjithashtu do të jetë një nga kushtet që bankat presin t'i kufizojnë gjatë TM3 2022. Faktori me indeksin negativ më të lartë rezultoi të jetë pozita e likuiditetit të bankave, gjë kontribuoi në pritjet për shtrëngim të kushteve dhe rregullave për TM3 2022. Njëkohësisht, bankat presin mbështetje dhe i shohin si faktorë pozitiv qasjen e favorshme në financim nga bankat amë, si dhe mbështetjen nga FKGGK.


### Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rritje edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me TM1 2022. Kërkesa për kredi rezultoi të jetë nënvlerësuar në pritjet e bankave për TM2 2022 të shprehura në anketën e kaluar (TM1 2022) (grafiku 3). Konkretisht, kërkesa për kredi nga NVM-të kishte rritje me indeks pozitiv prej 0.19, përderisa kërkesa kreditore nga ndërmarrjet e mëdha gjeneroi indeks pozitiv prej 0.18. Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi u ndikua nga përgjigjet e shtatë bankave të cilat deklaruan rritje të kërkesës deri në një masë, dhe nga përgjigjja e një banke me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditim, e cila deklaroi rënie të konsiderueshme të kërkesës.

Sipas anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, si dhe financimin e investimeve fikse me indeks pozitiv të ulët prej 0.14 dhe 0.11, respektivisht. Rezultati i faktorëve kontribuues në kërkesën për kredi u përcaktua nga përgjigjet e gjashtë bankave, të cilat deklaruan rritje të kërkesës për financim të inventarëve dhe kapitalit punues dhe për financim të investimeve fikse. Sidoqoftë, një bankë me rëndësi sistemike deklaroi se për të dy faktorët e lartëpërmendur kishte kërkesë konsiderueshëm më të ulët, gjë që edhe rezultoi në indeks të ulët pozitiv. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë TM2 2022.

Sipas anketës, gjatë TM2 2022 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive është në rënie me indeks negativ marginal prej 0.04, megjithatë në anketën e kaluar përgjigjet e bankave gjeneruan indeks negativ më të lartë prej 0.11 të këtij raporti. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistemike deklaruan rënie të kredive jo-performuese përderisa tre bankat tjera ndër to një bankë me rëndësi sistemike deklaruan rritje të tyre.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Bankat presin rritje në nivel marginal të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm. Këto pritje u ndikuan nga përgjigjet e gjashtë bankave, ku pesë prej tyre me peshë më të vogël presin rritje deri në një masë të kërkesës. Sidoqoftë, një bankë me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditimin nga sektori bankar, deklaroi që pret rënie deri në një masë të kërkesës për kredi. Rrjedhimisht, këto përgjigje rezultuan në një indeks pozitiv mirëpo të ulët nëse e krahasojmë me kërkesën aktuale për kredi, saktësisht rezultoi indeks pozitiv 0.06 për TM3 2022. Njëkohësisht, bankat nuk presin ndryshime të rëndësishme sa i përket cilësisë së aplikacioneve të pranuar për kredi.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të ndërroj kahje dhe të kaloj në indeks pozitiv prej 0.17, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditorë. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe rënia e fuqisë blerëse të klientëve. Pesë banka, ku tre prej tyre me rëndësi sistemike, deklaruan pritje për rritje të kredive joperformuese të ndërmarrjeve, ndërsa një bankë po ashtu me rëndësi sistemike deklaroi pritjet për rënie të tyre.


## Kreditë ndaj ekonomive familjare

### Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022 përgjithësisht u lehtësuan, megjithëse lehtësimi kryesisht u aplikua në standardet kreditore për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.15, ndërkohë që standardet kreditore për kreditë për blerjen e shtëpive mbetën pothuajse të pandryshuara. Rezultati kryesisht reflekton përgjigjet e tre bankave, ku dy prej tyre janë me rëndësi sistemike. Pritjet për tremujorin e dytë 2022, të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar, rezultuan të sakta (grafiku 4). Bankat deklaruan të kenë rritur normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare, në një masë më të madhe për kreditë konsumuese, me indeks pozitiv prej 0.28, se sa për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.12.

Faktorë që kontribuan pozitivisht në lehtësimin e standardeve kreditore ishin rritja e presioneve të konkurrencës me indeks pozitiv prej 0.31, qasja e favorshme në financim e bankave amë me indeks pozitiv prej 0.28, si dhe cilësia e mirë e portfolios kreditorë me indeks pozitiv prej 0.19.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuuan




Burimi: BQK.

Në tremujorin e tretë 2022, bankat presin standarde kreditore të shtrënguara edhe pse në nivel të ulët, veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks negativ prej 0.09. Përderisa, standardet kreditore për kreditë konsumuese u lehtësuan marginalisht me indeks pozitiv 0.06. Standardet kreditore pritet të ndikohen negativisht nga prospektet jo të favorshme në tregun e patundshmërive, përderisa faktorë që priten t'a ndikojnë pozitivisht janë rritja e presioneve të konkurrencës dhe qasja e favorshme në financim e bankave amë. Njëkohësisht, bankat presin rritje të nivelit të aprovimit të kredive për kreditë konsumuese në nivel të përafërt me tremujorin paraprak. Ndërsa, pritet rënie e normave të aprovimit të kredive për kreditë për blerjen e shtëpive në nivel të ulët. Saktësisht, rezultatet e përgjigjeve gjeneruan indeks pozitiv prej 0.09 për kreditë konsumuese dhe indeks negativ 0.08 për kreditë për blerjen e shtëpive.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u lehtësuan edhe pse në nivel të ulët. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë lehtësime për kreditë konsumuese, ndërsa shtrëngim për disa prej kushteve për kreditë për blerjen e shtëpive. Saktësisht, për kreditë konsumuese, bankat aplikuan kërkesë më të ulët për kolateral (indeks pozitiv prej 0.10), normë më të ulët të interesit dhe rritën shumën e kredive të aprovuara (indeks pozitiv prej 0.07). Ndërsa për kreditë për blerjen e shtëpive bankat aplikuan shtrëngime kryesisht për ngarkesat tjera përveç interesit dhe për maturitetin e kredive (indeks negativ prej 0.09 dhe 0.06, respektivisht), përderisa u lehtësuan kërkesat për kolateral (indeks pozitiv prej 0.10) (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët kryesor që kontribuuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht cilësia e mirë e portfolios kreditore, presioni i rritur i konkurrencës, si dhe qasja e favorshme në

financim e bankave amë. Përderisa, perspektiva jo e favorshme e tregjeve globale kontribuoi negativisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat gjatë TM2 2022.

Për tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat në përgjithësi presin shtrëngim në kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare. Shtrëngimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë i përafërt për të dy kategoritë e kredive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për kreditë konsumuese pritet të shtrëngohen përmes rritjes së normës së interesit dhe rritjes së ngarkesave tjera përveç interesit, përderisa lehtësim në nivel të ulët pritet të ketë në kërkesat për kolateral dhe maturitet të kredive. Kushtet dhe rregullat e njejta pritet të shtrëngohen edhe për kreditë për blerjen e shtëpive, si dhe shumica e aprovuar pritet të jetë e kufizuar deri në një masë, ngjajshëm lehtësim pritet të ketë për maturitetin e kredive dhe kërkesat për kolateral. Perspektiva e tregut të patundshmërive në vend, besueshmëria e klientëve, si dhe perspektiva jo e favorshme në tregjet globale pritet të jenë faktorët nxitës të shtrëngimeve të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM3 2022. Përderisa, për lehtësime faktorët nxitës pritet të jenë qasja e favorshme në financim e bankave amë si dhe perspektiva e mirë e tyre.

### Kërkesa për kredi


Bankat në këtë tremujor raportuan për rritje të kërkesës nga ekonomitë familjare, e cila në përgjithësi është e përgjysmuar në krahasim me rritjen e kërkesës gjatë tremujorit të kaluar (TM1 2022). Gjashtë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi, e që pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi me indeks pozitiv të lartë prej 0.26 (indeks pozitiv 0.50 në TM1 2022). Bankat raportuan për rritje dukshëm më të lartë të kërkesës për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.37 dhe 0.15, respektivisht. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i lartë, ndikuar nga vlera aktuale e kërkesës për të dy llojet e kredive e cila është më e lartë se sa pritjet e deklaruara nga bankat (grafiku 6).

Kjo rritje u ndikua pozitivisht kryesisht nga dy prej faktorëve të listuar në anketë, saktësisht nga nevoja për financim të konsumit dhe në një nivel më të ulët nga përmirësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive me indeks pozitiv prej 0.31 dhe 0.15, respektivisht. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare për kredi gjatë këtij tremujori u përmirësua në nivel të ulët për të dy llojet e kredive, saktësisht me indeks pozitiv prej 0.13 për aplikacionet për kreditë për blerjen e shtëpive dhe indeks pozitiv prej 0.10 për aplikacionet për kreditë konsumuese.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditorë për ekonomitë familjare, bankat deklaruan përkeqësim marginal, duke reflektuar përgjigjet e pesë bankave (një prej tyre me rëndësi sistemike) për rritje të raportit të kredive jo-performuese dhe dy banka (një prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan rënie të këtij raporti, e që rezultuan në një indeks pozitiv 0.06.

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, vetëm nga kreditë konsumuese. Pritjet për rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi u ndikuan nga përgjigjet e shtatë bankave (tre prej tyre me rëndësi sistemike). Sidoqoftë, një bankë me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditim, deklaroi që pret rënie të kërkesës kreditorë, gjë që ndikoi në zvogëlimin e rezultatit të agreguar të kërkesës për kredi në 0.20. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që nevoja për financimin e shpenzimeve për konsum të ndikojnë deri në një masë kërkesën për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm. Bankat deklaruan se nuk presin ndryshime të mëdha në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi nga ekonomitë familjare.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore gjatë TM3 2022, bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të përkeqësohet tutje, bazuar në rritjen e indeksit pozitiv krahasuar me tremujorin aktual. Saktësisht, pritjet e bankave për raportin e kredive joperformuese rezultuan në indeks pozitiv 0.17, deklaruar nga pesë banka (dy prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të këtij raporti dhe një bankë me rëndësi sistemike e cila pret rënie të të njejtit.


## Financimi

Bankat raportuan rritje të qasjes në financim gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e shtatë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, dhe një banke me rëndësi sistemike e cila deklaroi rënie deri në një masë të qasjes në financim. Në rritje kontribuan pothuajse të gjitha burimet e financimit për sektorin bankar.

Për dallim nga qasja e pandryshuar në financim gjatë tremujorit të kaluar, në këtë tremujor gjithsej financimi shënoi rritje, bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve. Depozitat e ekonomive familjare gjeneruan një indeks pozitiv prej 0.24 (indeks pozitiv prej 0.14 në TM1 2022). Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e shtatë nga gjithsej dhjetë banka pjesëmarrëse në anketë, ku gjashtë banka deklaruan rritje të financimit dhe një deklaroi rënie deri në një masë. Përderisa, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve krahasuar me tremujorin paraprak ndërroi kahje dhe shënoi rritje marginale me indeks pozitiv 0.08 (indeks negativ prej 0.21 në TM1 2022), duke reflektuar gjithashtu përgjigjet e tetë bankave pjesëmarrëse, gjashtë me rritje dhe dy me rënie të financimit nga kjo kategori. Ndryshim i lartë dhe që duhet të theksohet është rritja e dukshme e financimit nga bankat amë, kategori e cila rezultoi me një indeks pozitiv prej 0.22 e që është niveli më i lartë prej fillimit të kësaj ankete. Katër nga gjithsej dhjetë banka deklaruan rritje të qasjes në financim nga bankat amë e prej tyre tre me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në sektorin bankar. Gjithashtu, financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare shënoi rritje edhe pse në një nivel më të ulët me indeks pozitiv prej 0.14 (grafiku 7). Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi kryesor për financim gjatë këtij tremujori.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim në një nivel më të lartë se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ndërmarrjeve pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.34, përderisa financimi nga depozitat e ekonomive familjare dhe nga bankat amë pritet të ketë lëvizje më të ulët me indeks pozitiv prej 0.17. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat deklaruan se presin që rritjen e financimit ta dominojnë depozitat me maturitet afatshkurtër me indeks pozitiv 0.40. Për dallim nga viti paraprak bankat presin po ashtu një rritje më të lartë të financimit afatgjatë me indeks pozitiv prej 0.22 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

### Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësori i anketës për tremujorin e dytë të vitit 2022 është plotësuar me pesë pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste, që ishin evidente qysh nga gjysma e dytë e vitit të kaluar, në dinamikat e kreditimit. Gjithashtu, bankat elaboruan edhe mbi ndikimin indirekt të inflacionit në pozitën e likuiditetit dhe rritjen eventuale të kostove të financimit të sektorit bankar. Për më tepër, një nga pyetjet zbërthen ofertën dhe kërkesën kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Gjatë vitit 2021 aktiviteti ekonomik kishte një rimëkëmbje të fuqishme e mbështetur nga një rritja e kërkesës së brendshme pas përmirësimit të gjendjes së pandemisë. Sidoqoftë, si në vend ashtu edhe në nivel global, ky rikuperim u përkthye në rritje të përgjithshme të çmimeve, tutje i amplifikuar me fillimin e luftës Rusi-Ukrainë në Shkurt 2022. Duke qenë se rritja e çmimeve ndikon negativisht fuqinë blerëse të konsumatorëve, është me rëndësi të kuptohet sjellja e sektorit bankar në të bërit biznes në këto dinamika, dhe perceptimi i sektorit mbi aftësinë ripaguese të klientëve.

Një pjesë e madhe e bankave deklaruan që si pasojë e rritjes së çmimeve në vend, gjatë tremujorit të dytë, kryesisht nuk ka pas ndryshim të ofertës kreditore, përderisa kërkesa kreditore kishte rritje. Megjithatë, sa i përket ofertës kreditore, në kushte të rritjes së vazhdueshme të çmimeve, pothuajse të gjitha bankat theksuan se presin që të ndryshojnë dhe përshtatin standardet kreditore dhe kushtet e ofruara për kredi gjatë tremujorëve në vazhdim. Kushtet që bankat parashohin se mund të ndryshojnë për të menaxhuar ndikimin nga rritja e çmimeve janë rritja e normës së interesit si për kredi ashtu edhe në depozita, rritja e nivelit të aplikimit të normave variable të bazuara në normën e Euribor-it, rishikim i politikës për kreditimi, si dhe ulje e raportit të borxhit ndaj të ardhurave për klientët me nivel të caktuar të të ardhurave. Në anën tjetër, pjesa me e madhe e bankave deklaruan se kishte kërkesë të shtuar për kredi gjatë këtij tremujori. Kërkesat për financim që u veçuan nga bankat ishin investimi apo parapagimi i kapitalit punues me qëllim të rezervimit të çmimit, si dhe investimi në patundshmëri. Ngjashëm bankat presin që rritja e kërkesës të vazhdoj, megjithatë ritmi i rritjes së saj përcillet me pasiguri. Nga përgjigjet e bankave vërehet më shumë pasiguri sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, bazuar në ndryshimet në pritje, ku një pjesë e bankave presin kërkesë të shtuar për kredi konsumuese, e njëkohësisht ka banka që presin shtyrje të kërkesës për kredi deri në një periudhë të stabilizimit të çmimeve në treg. Gjithashtu, pritet që kërkesa për kreditë hipotekare të bie në periudhën në vijim si pasojë e pasigurive të shtuara.

Aspekt tjetër i mbuluar nga pyetjet shtesë ishte edhe ndikimi i rritjes së çmimeve në aftësinë e ripagimit të kredive nga klientët. Sentimenti i bankave nga përgjigjet e marra tregon se bankat besojnë në kapacitetin absorbues të klientëve të tyre, në periudhën afatshkurtër, pritje të cilat u bazuan në procesin e tyre të shqyrtimit të aplikacioneve për kredi dhe monitorimit të shtuar gjatë



kësaj periudhe. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e bankave deklaruan se presin që gjatë tremujorëve në vazhdim të vitit 2022, duke marr parasysh vazhdimin e presioneve inflacioniste në vend dhe jashtë tij, të ndikohet negativisht aftësia ripaguese e klientëve, e rrjedhimisht edhe cilësia e portfolios kreditorë të bankave.

Në njërën anë, rritja e vazhdueshme e çmimeve në treg ndikon në zvogëlimin e të hyrave të disponueshme, gjë që reflektohet në kufizimin e mjeteve që mbahen në sektorin bankar. Njëkohësisht, në anën tjetër për të siguruar financimin nga depozitat bankat kanë filluar dhe pritjet të vazhdojnë me rritjen e normave të interesit në depozita, gjë që përkthehet në rritjen e kostos së bankave për financim. Për më tepër, rritja e normave të interesit nga BQE po ashtu pritjet të ndikoj koston e financimit. Këtë dinamikë bankat deklaruan se nuk e shohin si rrezik eminent për pozitën e likuiditetit të tyre, bazuar në rezervat e larta që tashmë i mbajnë dhe mbështetjen nga bankat amë për likuiditet. Sidoqoftë, kjo i vije në pozitë më të ndjeshme bankat vendore për të cilat mjeti kryesor për sigurimin e depozitave mbetet rritja e normave të interesit në depozita. Të gjitha bankat e anketuara deklaruan për rritje të kostos së financimit në këtë tremujor si dhe pritjet e njëjta për periudhat në vijim, kohëzgjatja e të cilave përcillet me pasiguri. Gjithashtu, rritja e kostove së financimit bëhet barrë në aspekt të kufizimit të hapësirës për kredi dhënie, e rrjedhimisht edhe në performancën financiare të sektorit. Megjithatë, rezervat nga fitimet e konsiderueshme nga vitet e kaluara pritjet të ofrojnë kapacitet të mjaftueshëm absorbues për sektorin bankar në periudhë afatshkurtër.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të dytë 2022, bazuar në shtrëngimet e standardeve kreditorë, sektori i ndërtimtarisë dhe ai i patundshmërive rezidenciale përbëjnë sektorët me ofertën më jo të volitshme. Përgjigjet e tre bankave për sektorin e ndërtimtarisë dhe dy bankave për sektorin e patundshmërive, e prej tyre një bankë me rëndësi sistemike dhe me peshë të lartë në gjithsej kreditimin e sektorit, reflektojnë shtrëngime të standardeve kreditorë për këta sektor, e që rezultuan në indeks negativ prej 0.15 dhe 0.10, respektivisht. Sektorët me ofertën më të volitshme edhe pse me indeks të ulët pozitiv ishin sektori i prodhimtarisë dhe ai i shërbimeve. Njëkohësisht, edhe kushtet dhe rregullat u shtrënguan kryesisht për sektorin e ndërtimtarisë me indeks negativ prej 0.14, ndërsa u lehtësuan në masë më të lartë për kreditimin e sektorëve të prodhimtarisë me indeks pozitiv prej 0.18. Po ashtu, për sektorin e tregtisë, përgjigjet e bankave rezultuan me indeks pozitiv marginal 0.09. Kërkesa për kredi shënoi rritje të ulët për të gjithë sektorët, përveç sektorit të patundshmërive. Sektorët me kërkesën më të lartë për financim ishin ai i tregtisë dhe i shërbimeve me indeks pozitiv prej 0.17 dhe 0.09, respektivisht. Sektori i ndërtimit rezultoi me indeks pozitiv marginal 0.08, megjithatë pesë banka prej tyre dy me rëndësi sistemike deklaruan rritje të kërkesës deri në një masë për këtë sektor. Sidoqoftë, ky rezultat u ndikua nga përgjigja e një banke me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditim e cila deklaroi rënie të konsiderueshme të kërkesës për të njëjtin.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara gjatë TM3 2022, bankat pritjet të aplikojnë ofertë deri në një masë të shtrënguar për pothuajse të gjithë sektorët. Ngjashëm edhe kërkesa për kredi pritjet të bie nga pothuajse të gjithë sektorët ekonomik. Saktësisht, bankat në një masë më të madhe pritjet të shtrëngojnë standardet kreditorë për sektorin e ndërtimtarisë dhe në nivel më të ulët për sektorin e patundshmërive (rezidencial dhe komercial). Njëkohësisht, edhe kushtet dhe rregullat pritjet të shtrëngohen për të gjithë sektorët mirëpo në masë më të madhe për sektorët e ndërtimtarisë dhe patundshmërive. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritjet të ketë rënie, ku sipas pritjeve të bankave rënia e kërkesës për kredi nga pjesa më e madhe e sektorëve u përkthye në indekse marginale. Kërkesa për financimin e sektorit të ndërtimtarisë dhe patundshmërive komerciale pritjet të ketë rënie deri në një masë më të lartë, sidoqoftë kjo pritje nga përgjigjet e bankave u karakterizua me indeks negativ marginal prej 0.12 dhe 0.09, respektivisht.

## Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK anketon institucionet financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin aktual, pyetësi adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e katërt të vitit 2022 dhe për vitin 2022 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

## Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin aktual si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

## Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në gusht të vitit 2022, bankat kanë vlerësuar nivel pak më të ulët të inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2022 krahasuar me tremujorin paraprak dhe presin një nivel edhe më të ulët në tremujorin e katërt të vitit 2022. Për vitin 2022 bankat presin se niveli i inflacionit do të jetë 9.7 përqind nga 3.4 përqind sa ishte në vitin 2021.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për tremujorin e dytë të vitit 2022 sugjerojnë se norma mesatare vjetore e inflacionit ishte rreth 12.6 përqind. Për tremujorin e tretë të vitit 2022 bankat presin se norma mesatare e inflacionit do të jetë 10.3 përqind. Shumica e bankave

(8 sosh) presin që inflacioni do të jetë mbi 8 përqind ndërsa bankat tjera (2 sosh) presin se inflacioni do të jetë nën këtë nivel.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

| Bankat           | TM3 2022     | TM4 2022    | 2022        |
|------------------|--------------|-------------|-------------|
| 1                | 10.0%        | 8.0%        | 10.0%       |
| 2                | 14.5%        | 13.2%       | 12.5%       |
| 3                | 4.2%         | 5.3%        | 7.0%        |
| 4                | 11.0%        | 9.0%        | 10.2%       |
| 5                | 14.0%        | 14.0%       | 12.0%       |
| 6                | 11.8%        | 9.5%        | 10.4%       |
| 7                | 9.0%         | 8.0%        | 8.0%        |
| 8                | 6.5%         | 6.5%        | 7.0%        |
| 9                | 10.0%        | 10.0%       | 7.0%        |
| 10               | 12.0%        | 13.0%       | 13.0%       |
| <b>Mesatarja</b> | <b>10.3%</b> | <b>9.7%</b> | <b>9.7%</b> |

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.


Siç ilustron nga figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë për një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur faktorët e mundshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, që kanë ndikuar në rritjen e shkallës së inflacionit:

- ✓ Pushtimi rus i Ukrainës dhe ndërprerjet e furnizimit. Për ekonominë globale, Rusia dhe Ukraina janë furnizues të rëndësishëm të lëndëve të para si energjia, metalet dhe produktet bujqësore dhe lufta ka vënë në pikëpyetje furnizimin e këtyre burimeve dhe ka përshpejtuar rritjen e çmimeve. Për shkak të pasigurisë së rreziqeve gjeopolitike, çmimet e mallrave mund të rriten më tej dhe kjo mund të përkthehet në kosto më të larta operative të prodhimit, të cilat përkthehen në çmime më të larta dhe pritshmëri më të larta inflacioniste;
- ✓ Rritja e çmimeve të derivateve të naftës por edhe të kategorive të tjera janë reflektuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve. Pra, zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si dhe prodhimi i ulët në Kosovë dhe varësia e madhe e ekonomisë së vendit nga importet ka ndikuar në rritjen e çmimeve;
- ✓ Kufizimet në ofertë si rezultat i pengesave të krijuara në zinxhirët e furnizimit si pasojë e pandemisë Covid-19, ku shumë kompani po e kanë të vështirë të gjejnë lëndë të para për të prodhuar produktet e tyre, ka ndikuar po ashtu në rritjen e çmimeve. Për më tepër, rritja e koston të transportit detar ka ndikuar në rritjen e çmimeve, sidomos të vajit, derivateve, materialit ndërtimorë, etj.

Pritjet e bankave për TM3 2022 dhe për gjithsej vitin 2022, duke pasur parasysh dinamikën me të cilat po karakterizohen çmimet në vend, mendojmë se janë të ulëta.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM3 2022 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)